

Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më _____.____. 2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “B&A-02” sh.a, NIPT K21720007H, me adresë: Njësia Bashkiake Nr.1, Lagja Nr.1, Rruga:“Shemsie Haka”, Ish Poligrafiku, përballë Kryegjyshitës Bektashiane, Ndërtesa Nr.1, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur - mallra.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: NR.REF- 31745-06-03-2022.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:“Blerje vaj hidraulik T-68 për kuzhinetat e katër hidroagregatëve në HEC Fierzë”.

Kohëzgjatja e kontratës: 3 (tre) muaj.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.76, datë 13/06/2022.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori ekonomik “KAPPA OIL” sh.p.k, NIPT J91402501L, me ofertë ekonomike 23,600,000 (Njëzetë e tre milion e gjashtëqind mijë) Lekë pa TVSH.
- 2- Operatori ekonomik “EXIMOIL” sh.p.k, NIPT K91715006E, me ofertë ekonomike 20,000,000 (Njëzetë milion) Lekë pa TVSH.
- 3- Operatori Ekonomik “TOP-OIL” sh.a, NIPT K16604717F1, me ofertë ekonomike 19,880,000 (Nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.
- 4- Operatori Ekonomik “Auto France Lubricants” sh.p.k, NIPT L11801014N, me ofertë ekonomike 26,000,000 (Njëzetë e gjashtë milion) Lekë pa TVSH.
- 5- Operatori ekonomik “B&A-02”sh.a, NIPT K21720007H, me ofertë 26,600,000 (Njëzet e gjashtëmilion e gjashtëqind mijë) Lekë pa TVSH.
- 6- Operatori ekonomik “ALBES GROUP” sh.p.k, NIPT J82916421N, me ofertë ekonomike 29,450,000 (Njëzetë e nëntë milion e katërqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

7- “O-SP Albania” sh.a, NIPT M11424016S & Dabar sh.p.k NIPT L62409033I me vlere oferte 29,280,000 (Njëzet e nëntë milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

8- Operatori ekonomik “Kadiu” sh.p.k, NIPT J61817045K, me ofertë ekonomike 29,200,000 (Njëzetë e nëntë milion e dyqind mijë) Lekë pa TVSH.

9- Operatori ekonomik “ELBA-OIL 2015” sh.a, NIPT L52606201T, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1- Operatori ekonomik “KAPPA OIL” sh.p.k, NIPT J91402501L, me ofertë ekonomike 23,600,000 (Njëzetë e tre milion e gjashtëqind mijë) Lekë pa TVSH, pasi:

✚ Nuk plotëson pikën 2.3.1 kapaciteti teknik, pasi nuk plotëson vlerën e kërkuar për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, pasi vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 12,459,200 Lekë.

✚ Kontrata e paraqitur nga ky operator nuk është e ngjashme pasi kontrata e lidhur midis Autoritetit Kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a dhe “Kappa Oil” sh.a, ka si objekt: “Blerje vaj, antifrizë, graso dhe alkol për automjete”.

✚ Faturat e paraqitura si furnizime të ngjashme nga ky operator janë fatura që kanë si objekt artikujt vaj makine, vaj transmisioni, graso, aditiv për automjete dhe nuk kanë lidhje me kontratën objekt prokurimi.

✚ Operatori ekonomik “KAPPA OIL” sh.p.k, nuk plotëson kriterin 2.3.3, pasi objekti i këtij autorizimi është “Blerje vaj lubrifikant”.

✚ Operatori ekonomik “KAPPA OIL” sh.p.k ka paraqitur formularin e ofertës (shtojca 1) me objekt: “Blerje vaj lubrifikant” dhe jo me objektin e prokurimit “Blerje vaj hidraulik T-68 për kuzhinetat e katër hidroagregatëve në HEC Fierzë”.

✚ Deklarata e paraqitur mbi transportin e mallrave mban datën 11.03.2022 dhe objekti për të cilin është lëshuar është “Blerje vajra lubrifikant”.

2- Operatori ekonomik “EXIMOIL” sh.p.k, NIPT K91715006E, me ofertë ekonomike 20,000,000 (Njëzetë milion) Lekë pa TVSH, pasi:

✚ Nuk plotëson pikën 2.3.1 kapaciteti teknik, në lidhje me vlerën e kërkuar për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, pasi vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 12,459,200 Lekë. OE ka paraqitur kontrata me autoritete shtetërore dhe fatura tatimore shitje ku shumica e artikujve të deklaruar nuk janë artikuj të ngjashëm, ato janë vajra, pajisje dhe lubrifikantë të ndryshëm për makina te tonazheve të ndryshëm.

✚ Nuk plotëson pikën 2.3.6 kapaciteti teknik, pasi në broshurën e prodhuesit të paraqitur nuk jepet asnjë e dhënë teknike mbi vajin e kërkuar.

3- Operatori Ekonomik “TOP-OIL” sh.a, NIPT K16604717F1, me ofertë ekonomike 19,880,000 (Nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH, pasi nuk plotëson pikën 2.3.1 kapaciteti teknik.

✚ Kontratat e paraqitur nga ky operator nuk janë të ngjashme pasi kontrata e lidhur midis Autoritetit Kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a dhe “TOP-OIL” sh.a ka si objekt: “Blerje vaj, antifrizë, graso dhe alkool për automjete”.

✚ Kontrata lidhur midis Komandës Mbështetëse dhe “TOP-OIL” sh.a, me objekt: “Blerje vaj lubrifikant”. Referuar artikujve të kësaj kontrate, rezulton se ky operator nuk plotëson vlerën e kërkuar për furnizimet e mëparshme të ngjashme për këtë kontratë, pasi ka zëra artikujsh të ndryshme si vaj motorri për automjete, vaj kutie shpejtësie, vaj armësh, antifrizë motorri etj. Pra ky operator nuk plotëson pikën 2.3.1 kapaciteti teknik, pasi vlera e kërkuar për furnizimet e kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, duhet të jetë jo më e vogël se 12,459,200 Lekë.

4- Operatori Ekonomik “Auto France Lubricants” sh.p.k, NIPT L11801014N, me ofertë ekonomike 26,000,000 (Njëzetë e gjashtë milion) Lekë pa TVSH, pasi:

✚ “Lista e çmimeve të artikujve” nuk është plotësuar sipas formatit të shtojcës 2.

✚ Nuk plotëson pikën 2.3.1 kapaciteti teknik, OE ka paraqitur si furnizime të mëparshme të ngjashme, fatura tatimore me vlerë më të vogël se vlera e kërkuar. Nuk plotëson vlerën e kërkuar për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, pasi vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 12,459,200 Lekë.

5- Operatori ekonomik “ALBES GROUP” sh.p.k, NIPT J82916421N, me ofertë ekonomike 29,450,000 (Njëzetë e nëntë milion e katërqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH, pasi:

✚ Nuk pranohet Shtojca 2, Lista e çmimeve të artikujve, pasi nga përlllogaritja rezulton që vlera totale është 2,945,000,000 Lekë.

✚ Nuk plotëson pikën 2.3.1 kapaciteti teknik, pasi nuk ka paraqitura dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit. Ky operator në lidhje me këtë kriter ka paraqitur vetëm fatura tatimore blerje dhe jo shitje.

✚ Nuk plotëson kriteret për kualifikim për pikat:

2.3.2 mbi disponimin e një magazine,

2.3.3 mbi autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar,

2.3.6 mbi paraqitjen e broshurës për lubrifikantin nga prodhuesi,

2.3.8 mbi paraqitjen e licensës së tregtimit të vajrave,

2.3.9 mbi paraqitjen e fletë analizave,

Për këto pika ka paraqitur vetëm deklaratat dhe asnjë nga dokumentat e kërkuara për kualifikim në lidhje me këto pika.

✚ Shtojca 8 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” nuk është plotësuar sipas formatit të kërkuar.

6- Operatori ekonomik “Kadiu” sh.p.k, NIPT J61817045K, me ofertë ekonomike 29,200,000 (Njëzetë e nëntë milion e dyqind mijë) Lekë pa TVSH, pasi:

✚ Nuk plotëson pikën 2.3.1 kapaciteti teknik, pasi nuk plotëson vlerën e kërkuar për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, pasi vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 12,459,200 Lekë. Faturat e ngjashme të paraqitura nga ky operator janë fatura që kanë si artikuj vaj motori, alkol frenash, antifrizë, bateri, filtër naftë, filtër vaji për automjete dhe nuk kanë lidhje me kontratën objekt prokurimi.

7- Operatori ekonomik “ELBA-OIL 2015” sh.a, NIPT L52606201T, pasi ky Operator ekonomik ka paraqitur vetëm ekstraktin e regjistrimit tregtar. Nuk ka paraqitur formular oferte dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e kriterëve për kualifikim të kërkuara në DT.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “B&A-02” sh.a, NIPT K21720007H, me adresë: Njësia Bashkiake Nr.1, Lagja Nr.1, Rruga:“Shemsie Haka”, Ish Poligrafiku, përballë Kryegjyshitës Bektashiane, Ndërtesa Nr.1, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 26,600,000 (Njëzet e gjashtëmilion e gjashtëqind mijë) Lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ergys Verdho